

DR. NURI DRAGOJ
(1951-2020)



Më 15 tetor 2020 në Tiranë ndërroi jetë gazetari, historiani dhe patrioti i njohur Nuri Dragoj, një personalitet me vlera të spikatura në çështjen e atdhetarisë dhe të publicistikës duke lënë pas një korpus të madh shkrimesh, monografish e vëllimesh studimore.

Nuri Dragoj lindi më 22 prill 1951 në Zhepovë të Përmetit. Studimet e larta i përfundoi në vitin 1976 për mjek veterinar. Gjatë viteve 1977-1986 do ta ushtronte profesionin e tij në fshatra të ndryshme të Përmetit ku, gjatë kësaj periudhe ka kryer edhe specializime të ndryshme pasuniversitare. Ndërsa pas viteve 1990 aktivitetin studimor do ta përqendronte në fushën e historisë duke fituar në vitin 2013 titullin Doktor i Shkencave Historike pranë Fakultetit të Historisë dhe të Filologjisë të Universitetit të Tiranës me temën “Treva e Përmetit në periudhën e viteve 1912-1944”.

Pas viteve 1990, Nuriun e gjejmë të angazhuar më së shumti në fushën e gazetarisë. Përveç shkrimeve të hershme tek “Zëri i Popullit”, pas vitit 1993 ai do të merrte gjerësisht pjesë në shtypin e shkruar duke qenë i pranishëm me artikujt e tij. Gjatë viteve 2003-2009 do të kryente edhe detyrën e kryeredaktorit të gazetës “Republika”. Përveç medimeve të nivelit kombëtar, ai do të kontribuonte edhe në atë lokal duke qenë kryeredaktor i gazetës mujore “Dëshnica”. Kontributi i tij në publicistikë do të shtrihej edhe tek revista të ndryshme të nxjerra nga shqiptarët e diasporës siç qe edhe “Dituria” në Suedi. Me dhjetëra shkrime të botuara, Nuriu do ta pasuronte publicistikën shqiptare me shkrime që preknin tematika serioze me të cilat përballej shoqëria, shteti dhe çështja kombëtare.

Në kuadër të aktivitetit personal, Nuri Dragoj gjithashtu do të mbante poste drejtuese në disa shoqata lokale e kombëtare duke

kontribuar me përvojën e tij. Gjatë viteve 2009-2016 do të kryente edhe detyrën e drejtorit të Bibliotekave dhe të Arkivit të Qendrës së Studimeve Albanologjike.

Në numrin e madh të botimeve që la pas, Dragoj i ka kushtuar një rëndësi të veçantë vendlindjes së tij, Përmetit, duke dhënë një kontribut të pamohueshëm në ndriçimin e historisë së kësaj treve gjatë periudhës 1912-1944 me veprat: *Dëshnica dhe dëshnicarët*, I-III, Tiranë 2005-2006; *Arsimi në Përmet (1912-1944)*, Tiranë 2015; *Përmeti dhe lufta për pavarësi*, Tiranë 2015; *Përmeti midis dy Luftërave Botërore*, Tiranë 2016; *Përmeti dhe Lufta e Dytë Botërore*, I-II, Tiranë 2018; *Përmeti, Organizimi administrativ, 1912-1939*, Tiranë 2019 dhe *Përmeti, Popullsia dhe shëndetësia, 1912-1944*, Tiranë 2019.

Një pjesë kryesore e veprimtarisë së tij publicistike që çështja kombëtare, të cilës Nuriu do t'i kushtonte botime, shkrime, konferenca e intervista duke e bërë këtë aspekt, kryetëm të aktivitetit dhe përpjekjeve të tij. Shumica e shkrimeve të tij nëpër gazetatat e medien e shkruar dhe asaj digjitale i përkisnin çështjes kombëtare. Ndër botimet e të ndjerit në lidhje me këtë temë veçojmë: *Rreziku i shkombëtarizimit*, Tiranë 2011; *Eshtra që akuzojnë*, Tiranë 2006; *Shqiptarët dhe grekët*, Tiranë 2009 dhe *Prapaskenat e Konferencës së Londrës*, Tiranë 2013. Në kuadër të përpjekjeve të tij për çështjen kombëtare vlen të përmendet fakti se Nuriu që njëri prej bashkëthemeluesve të Aleancës Kuq e Zi.

Dragoj është marrë në mënyrë të veçantë edhe me periudhën e komunizmit dhe fatin e shkrimtarit të asaj kohe duke u fokusuar tek njëra prej figurave më emblematike, Kasëm Trebeshina. Një studim i botuar fillimisht më 2007 si *Dozja Trebeshina dhe prapaskenat e lidhjes*, Tiranë 2007 dhe më 2009 i risjellë më i plotësuar me titullin *Trebeshina, një jetë para gjyqit*. Po në këtë kontekst vlen të përmendim edhe punimin me titull *Xhevahir Spahiu, sfidat e poetit*, të sjellë nga autori në vitin 2012.

Përveç anës profesionale dhe krijimtarisë voluminoze që la pas, Nuri Dragoj veçohet nga të gjithë kolegët e bashkëpunëtorët për pozitivitetin dhe vlerat humane që e karakterizonin. Me karakterin e tij optimist, me sinqeritetin, punën e palodhur, energjinë, gatishmërinë dhe virtytet e tjera që ai posedonte, Nuriu që një shembull i mirësisë dhe njeriut me vlera.

Vdekja e Nuri Dragoit përbën një humbje për kolegët e tij, veçanërisht për ata që merren me historinë e Përmetit, për të gjithë

atdhedashësit si dhe një mungesë të madhe për të gjithë ata intelektualë e njerëz të penës me integritet dhe virtyt.

Eduart ÇAKA